



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

FORUMI I SOLAREVE NË KOSOVË

ZHVILLUESIT
DHE INSTALUESIT E
SOLAREVE NË KOSOVË
DHE RAJON

**21-22 KORRIK,
2022**



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

ZHVILLUESIT DHE INSTALUESIT E SOLAREVE NË KOSOVË DHE RAJON



AKUO

I themeluar në vitin 2007, Akuo është prodhues dhe zhvillues i pavarur dhe global i energjisë së ripërtërishme. Grupi u krijua me një mision: të sigurojë energji elektrike të pastër dhe të gjelbër për njerëzit në mbarë globin duke përshpejtuar tranzicionin energjetik dhe duke ndihmuar në nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Akuo Group është i pranishëm në të gjithë zinxhirin e vlerës, duke përfshirë zhvillimin e projektit, financimin, ndërtimin dhe operimin. Grupi ka investuar më shumë se 2.8 miliardë euro deri në fund të vitit 2021 dhe aktualisht ka një kapacitet total prej 1.4 GW në operim dhe/ose në ndërtim e sipër, si dhe 7 GW në projekte në zhvillim.

Akuo Group po zgjerohet me shpejtësi dhe tani ka një prani solide në 17 vende/rajone: Bullgari, Evropë Qendrore, Kolumbi, Francë, Greqi, Oqeani Indian, Indonezi, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Rajoni i Paqësorit, Poloni, Portugali, Serbi, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe ShBA.

Vlerat që drejtojnë punën e grupit përmbledhen në kredon e tij, "natyrshëm ndërmarrës". Akuo është i përkushtuar ndaj sjelljes së ndryshimeve në komunitete, fuqizimit të qytetarëve, si përkrahjes së bujqësisë së qëndrueshme.

Deri më sot, parqet energjetike me erë dhe solare të Akuo-s kanë ndihmuar në reduktimin e më shumë se 800,000 tonë CO2 në vit dhe sigurimin e energjisë së gjelbër dhe të pastër për më shumë se 800,000 familje në mbarë botën.

Akuo Group ka më shumë se 450 të punësuar të përkushtuar që çdo ditë jetësojnë misionin dhe vlerat e tij.

Në Kosovë, Akuo aktualisht është i angazhuar në zhvillimin e idesë së konceptit për Parqet me Erë 1 dhe 2 të Cicavicës – një projekt hibrid prej 90.1 MW kapacitet prej erës dhe 25 MW kapacitet solar, që do të ndërtohen në Komunën e Vushtrrisë.

Adresa: Rr. Ferid Curri, Obj.Molla, H.1, B.1, Arberi, 10000 Prishtine, Kosova

E-mail: kastrati@akuoenergy.com

Website: www.akuoenergy.com



Alfa

Solar Energy

ALFA SOLAR ENERGY

Alfa Solar Energy L,L,C është një kompani që operon në fushën e energjisë së rinovueshme, konkretisht në sektorin e paneleve fotovoltaike. Kompania jonë përpos që bën projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve fotovoltaike në Kosovë, ka arritur të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare, ku kemi dizajnuar projekte në shtetet si: Gjermania, Italia, Holanda, Spanja dhe Polonia.

Alfa Solar ofron një gamë të gjerë produktesh cilësore të kompanive të mirënjohura gjermane, austriake, italiane dhe zviceriane, kompani të cilat për vite me rradhë janë fituese të çmimeve të para për cilësi dhe kualitet. Disa prej tyre janë SolarWatt, ASP, Fronius, SMA, K2 Systems. Të gjitha produktet vijnë me një garanci shumëvjeçare. Një tjetër avantazh është stafi ynë i kualifikuar dhe profesional. Stafi përbëhet nga inxhinierë të specializuar në fushën e fotovoltaikëve.

Pasioni

Ne kemi fatin të bëjmë atë që duam. Nga kolegu i parë deri tek ai i fundit, të gjithë në "Alfa Solar Energy" ndajnë një pasion për energjinë solare. Ka qark shumë arsye për tu entuziazmuar në lidhje me energjinë solare, është zgjidhja e problemeve të shumta në botën tonë sot.

Vizioni

Për të siguruar karakteristikat më tërheqëse në industrinë e energjisë solare. Vlera, siç përcaktohet nga klientët tanë, nënkupton projektimin dhe instalimin e sistemeve të energjisë me cilësinë më të lartë, në kohë, në mënyrë të sigurt, me kënaqësi të lartë të klientit, me një kosto të ulët.

Misioni

Promovimi i energjisë së ripërtëritshme. Kjo do t'u japë klientëve tanë, komuniteteve tona dhe kombit tonë energji të pastër, të bollshme, me kosto të ulët dhe të shpërndarë.

Adresa: Prishtinë, Rruga Shaqir Igrishta, Ban. II nr 32

Mob: +383 (0) 49 676 387

E-mail: support@alfasolar-ks.com

Website: www.alfasolar-ks.com



CALL HOME ELECTRONICS

E themeluar në vitin 2011 me seli në Prishtinë, Republika e Kosovës, "Call Home Electronics" shpk (CHE shpk) u krijua me idenë për të zbatuar projekte në fushën e efijencës së energjisë dhe atë në dy fusha të veçanta të efijencës: e para përmes sistemeve solare – fotovoltaike dhe e dyta përmes sistemeve për menaxhimin e ndërtesave – BMS që reduktojnë shpenzimin e energjisë 30 – 60%.

Duke arritur suksese në këto fusha, me mirënjohje dita ditës në Kosovë dhe më gjerë, dhe bazuar në kërkesa të shumta dhe nga më të ndryshmet nga klientët tanë, kompania jonë u detyrua të ofrojë shërbime profesionale edhe në fusha tjera të automatizimeve dhe sigurisë.

Sot, pas 10 vitesh, CHE shpk ofron shërbime profesionale në:

- Sisteme solare ON dhe OFF Grid
- Ndriçim i jashtëm solar dhe smart (rrugorë, parqet etj.)
- Sisteme për menaxhimin e ndërtesave me reduktim deri 60%
- Ndriçimi Emergjent Inteligjent
- Sistemet të ndryshme automatizimi dhe të sigurisë
- Smart Home ku në aplikacionet tona gjithmonë ka vend edhe monitorimi i sistemeve solar.

Pra CHE shpk sot ofron shërbime profesionale në zbatimin e projekteve të ndryshme nga këto fusha dhe gjithmonë duke iu përshtatur nevojave të klientëve tanë, qofshin publik apo privatë. Një tjetër angazhim i yni është edhe dega jonë në Stuttgart të Gjermanisë, e cila operon në fushat e njëjta që nga viti 2018.

Adresa: Veternik EXDC-3 L-8 Nr.3, 1000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 (0) 44 40 60 40 | **Mob:** +386 (0) 49 315 315

E-mail: call-home@hotmail.com

Website: www.smart-elektrotech.com



ELECTRA

Electra është kompani e themeluar në vitin 2008. Që nga fillimi misioni i kompanisë ka qenë të përkujdeset të ofroj shërbime më cilësore në fushën e energjisë, produkte me cilësi më të lartë me çmime konkurruese, me shërbime që tejkalojnë pritjet e klienteve. Ne vazhdojmë të investojmë në objekte, sisteme dhe personel teknik të trajnuar duke siguruar vlera të shtuara për marrëdhëniet tona të biznesit.

Electra është kompani lidere në implementimin e projekteve të energjisë së ripërtitshme ku vlen të cekem këto projekte:

- Parku energjetik me Erë Kitka 32.5MW,
- Parku photovoltaik Madanaj 6MW
- Parku photovoltaik SGE Kamenicë 3MW
- Mini hidrocentralet Dragash, Brezovice dhe Kaçanik.

Po ashtu Electra ka të zhvilluar edhe departamentin e prodhimit ku bënë prodhimin e këtyre paisjeve:

- Prodhimi i paneleve 24kV nën licencën e ABB,
- Prodhimi i paneleve 36kV nën licencën e Schneider Electric,
- Prodhimi i paneleve 0.4kV nën licensën e Schneider Electric.

Si sektor tjetër Electra ka zhvilluar edhe shitjen e materialit elektrik ku edhe është distributore e kompanive të ndryshme botërore si: Schneider Electric, MEGGER, Sigma Elektrik, Prysmian, Philips, ABB etj.

Ne vëmë punën, vëmendjen në detaje dhe vendosmëri në çdo projekt që e përfundojmë në Electra. Kompania Electra përpiqet të jetë më e mira si shpërndarës i produkteve dhe shërbimeve cilësore dhe është përgjegjëse për t'u ofruar klientëve tanë ide të reja, paisje të përshtatshme dhe teknologji të përditësuar për projekte më efikase.

Adresa: Magj. Prishtine-Lipjan, Suhodoll. Kosovë

Tel: + 383 (0) 38 605 111 | Mob: +383 (0) 49 301 050

E-mail: valon.gashi@electra-ks.com

Website: www.electra-ks.com



ELEN

Elen është një kompani e specializuar në ofrimin e shërbimeve të projektimit dhe zbatimin e projekteve të energjisë së ripërtëritshme, instalimeve elektrike, akumulimin e energjisë, "Micro-grid" dhe në eficiencën e energjisë.

Qëllimi ynë gjithmonë është t'i vendosim njerëzit dhe nevojat e tyre në qendër të asaj që bëjmë. Vetëm në këtë mënyrë, ne mund të jemi të dobishëm për klientët tanë.

Misioni ynë për 30 vite ka qenë të punojmë me standardet më të larta të etikës së biznesit dhe të krijojmë vlerë nga e cila klientet tane ndihen të sigurt në investimet e tyre.

Përveç tjerash, ne hartojmë, zhvillojmë, dhe zbatojmë projekte të energjisë së rinovueshme dhe zgjidhje të eficiencës së energjisë jo vetëm për të rritur kursimet por edhe për të zvogëluar emetimet e CO2 për ambientin dhe klientët tanë.

Adresa: Sheqir Dulahi Nr.5, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel/Fax: +383 (0) 38 220 563 / +383 (0) 44 566 999

E-mail: info@elen-ks.com

Website: www.elen-ks.com



Bitfox shpk

Kompania jonë ofron të gjitha llojet e shërbimeve me energji të ripërtëritshme, shitje të produkteve dhe implementimeve të projekteve.

Adresa: Brigada 123, Suharekë, Kosovë

Tel: +383 (0) 44 274 941

E-mail: info.bitfox@gmail.com

Website: www.bitfox.org



ESCO

ESCO ofron konsulencë, inxhiniering dhe realizim të sistemeve fotovoltaike. ESCO është pjesë e familjes së S.Imeri Company që është themeluar në vitin 2000. Kompania jonë është rezultat i bashkëpunimit me kompanitë më të mëdha të energjisë së ripërtëritshme nga Gjermania dhe Italia (BOSCH, M2G, etj.) dhe Bankës Evropiane Për Zhvillim, të cilat kanë dhënë eksperiencën e tyre të vlefshme në këtë industri. Me një bazament të fortë për zhvillim dhe strategji të qartë, ESCO është kompania inxhinierike premium me aktivitet ekskluziv në industrinë e energjisë.

ESCO është e para që në Kosovë ka aktivizuar sistemin solar ON-GRID me parimin NET-METERING. Kjo do të thotë se energjia e tepërt që prodhon sistemi solar, kur juve nuk ju duhet, futet në rrjet, me ç'rast zbritet fatura e energjisë elektrike dhe po të njëjtën ju mund ta merrni në një kohë tjetër kur keni nevojë për energji.

Adresa: Rr. Nënë Tereza, Kati III, 50000 Gjakovë, Kosovë

Tel: +383 (0) 48 635 035

E-mail: info@esco-ks.com

Website: www.esco-ks.com



ESK Solar

Kompania Esk Solar ofron shitjen dhe montimin e të gjithë paisjeve për panele solare.

Adresa: Brigada 124, Suharekë, Kosovë

Tel/Fax: +38349412593

E-mail: esk.solar@gmail.com



Future Energy Solution

Instalime të paneleve fotovoltaike, konsulencë për instalime fotovoltaike, etj.
Shitblerje të paneleve dhe aksesorëve.

Adresa: Rruga B. Nr. 156

Tel: +38349858537

E-mail: info@future-energy-solution.com

Website: www.future-energy-solution.com



ELEKTROSTUBLLA

Që nga viti 1986, ne kemi punuar në inxhinieri elektrike. Kompania ElektroStublla është themeluar zyrtarisht në vitin 1992 nga Ing. Marjan Ramaj. Për periudhën 1992-2000 suksemi ynë ishte i paplotë për shkak të politikës, çështjet e asaj kohe në Kosovë, por më pas të arriturat tona janë arritur pas luftës së Kosovës. Ne filluam prodhimin e tubave të valëzuar në vitin 2001 dhe në vitin 2013 u bëmë lider i inxhinierisë elektrike në Republikën e Kosovës.

Sot ElektroStublla mban mbi 50 produkte të standardit evropian dhe zotëron certifikatën ISO 9001.

Nëse keni pyetje të tjera, ose keni nevojë për sqarime shtesë, mund të më kontaktoni drejtpërdrejt ose ne mund të organizojmë një takim personal me ju në kompaninë tuaj.

Ne zotërojmë një ekip prej 70 punonjësish dhe tre pika shitjeje, si dhe projektojmë projekte të reja. Kemi zhvilluar dhe po finalizojmë 4 projekte të energjisë diellore.

Jemi prezantues në panairë ndërkombëtare, me produktet tona.

Adresa: Hoxhë Jonuzi nr. 53, Viti, Kosovë

Tel: +38349100105

E-mail: kr@elektrostublla.com

Website: www.elektrostublla.com



Foton

S O L A R

Foton Solar LLC

Foton Solar LLC ka për synim projekte inovative në fushën e energjisë së ripërtritshme duke ofruar shërbime dhe produkte për impiante fotovoltaike. Foton Solar LLC ka staf të certifikuar në instalimin dhe mirëmbajtjen e paneleve solare duke ofruar produkte të çertifikuara të teknologjisë së fundit me efikasitet 22.3 % dhe të cilat punojnë të ndara për çdo rend qelizash.

Foton Solar LLC filloi si ide duke parë nevojën për veprime të menjëhershme për mbrojtje të ambientit dhe arritjet e fundit të teknologjisë në fushën e energjisë së ripërtritshme nga energjia solare. Panelet tona solare janë të shfrytëzueshme duke filluar nga hapësirat shtëpiake, komerciale e deri tek fermat për prodhimin e energjisë së ripërtritshme për tregje të mëdha.

Produktet kryesore që ofrojmë janë: Panele fotovoltaike me fuqi dhe dimensione të ndryshme, Inverter OnGrid, OffGrid dhe Hibrid, Mbajtëse të llojeve të ndryshme për kulme, etj.

Adresa: Ferizaj, Kosovë

Tel: +383 (0)49 426 222

E-mail: info@foton-solar.com

Website: <https://foton-solar.com>



GET GROUP

Ne jemi një kompani që ka më shumë se 10 vjet përvojë në mjedis dhe energji Solare PV. Selitë tona janë në Prishtinë dhe Tiranë.

Pjesa më e madhe e portofolit të biznesit tonë është shoqëruar me projekte të mbështetura nga USAID, UNDP, BE, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Ekonomisë.

Shërbimet

Ne njihemi për përkushtim në ofrimin e shërbimeve të kërkuara për të përmbushur nevojat aktuale të klientëve. Aftësitë tona janë të ndryshme, por të lidhura – duke na lejuar të bashkojmë ekipe me aftësitë e nevojshme të specializuara në fushën e sistemeve solare fotovoltaike (PV).

Mjedis

Gjatë 10 viteve të fundit, ne kemi punuar për të përmirësuar mjedisin në sektorin publik dhe privat, duke përfshirë kompani nga me te ndryshmet, komunat, dhe organizatat ndërkombëtare të zhvillimit.

Energjia dhe Eficienca e Energjisë

Ne kemi një portofol të gjerë shërbimesh për të ndihmuar klientët tanë në ofrimin e projekteve të energjisë Solare PV. Ne gjithashtu kemi ekspertizë të rëndësishme në rritjen e produktivitetit dhe konkurrencës së NVM-ve prodhuese me energji Solare PV.

Politikat

Jemi një lojtar i rëndësishëm në përcaktimin dhe zhvillimin e kornizave të politikave brenda shtyllave kryesore të punës sonë, kryesisht mbrojtjen e mjedisit, dhe zhvillimin e energjisë bazuar ne Solar PV.

Eksperiencat:

Disa nga klientët tanë që kanë besuar tashmë tek ne janë:

- Ministry of Economic Development
- USAID
- UNDP
- Green for Growth Fund
- European Commission Office in Kosovo
- ProCredit Bank

Adresa: Rr. Mbreti Genc p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 (0) 38 748 822 | Mob: + 383 (0) 49 875 100

E-mail: info@get-ks.com / visar.kelmendi@get-ks.com

Website: www.get-ks.com

Facebook: <http://www.facebook.com/pages/GET-Green-Energy-Technologies/1483494825253513>

Instagram: <https://www.instagram.com/getgreenpower/>



GÜRİŞ

Güriş Energy Group

Prej themelimit të vet në vitin 1958, Güriş ka qenë një nga kompanitë kryesuese kontraktuese në Turqi. Përveç se në Turqi, Güriş ka kryer aktivitete biznesi në Lindjen e Mesme, Azinë e Afërt dhe Qendrore, Komonuellthin e Shteteve të Pavarura dhe Afrikën e Veriut. Duke përfunduar një gamë të gjerë projektesh me çelësat në dorë, Güriş vazhdon të kontribuojë në të gjithë sektorin e ndërtimitarisë. Aktualisht, Güriş është brend lider në rajon me më shumë se 40 filiale dhe 8,000 të punësuar.

Güriş Energy Group është kryesisht aktiv në gjenerim në kuadër të strukturave afatgjata me tarifa nxitëse. Kompania është pioniere në investimet në energjinë e ripërtërishme dhe operatori i impiantit më të madh energjetik me erë në Turqi, me 634.5 MW kapacitet total të instaluar dhe në funksionim në Turqi. Ai është gjithashtu operatori më i madh i impiantit më të madh energjetik gjeotermal në Turqi për sa i përket prodhimit që nga viti 2022, dhe një nga operatorët më të mëdhenj të impianteve energjetike gjeotermale në Evropë.

Güriş ka portofol operacional të energjisë së ripërtërishme prej më shumë se 1,063 MW në Turqi dhe Evropën Lindore:

- 12 impiante energjetike me erë > 699.3 MW (64.8 MW jashtë vendit)
- 9 impiante energjetike gjeotermale > 259.9 MW
- 6 hidrocentrale > 104.4 MW
- 67.2 MW aktualisht në ndërtim

Güriş është aktiv në tregun kosovar. Në vitin 2018, Güriş autorizoi projektin e impiantit me erë Kitka me kapacitet prej 32.4 MW. Aktualisht, Güriş është në proces të zhvillimit të projektit hibrid energjetik me erë dhe solar të quajtur Air Energy II, me kapacitet prej 99.6 MW.

Adresa: Fshati Polickë, Kamenicë, Kosovë

E-mail: info@guris.com.tr

Website: www.guris.com.tr



INTERING

Intering është kompani private, e specializuar në prodhimin, çmontimin, montimin, instalimin, riparimin dhe remonetet në fushën e pajisjeve minerare, termocentraleve dhe energjisë solare.

Intering ka qenë aktive në sektorin energjetik kosovar për më shumë se 20 vjet dhe ka qenë pioniere e një prej projekteve të para fotovoltaike solare në shkallë më të vogël në Kosovë:

- **ONIX 0.5 MW** – për përdorim komercial
- **ONIX Spa** – prodhim 0.4 MW për nevoja vetë-konsumi në kompleksin e ONIX spa
- **Intering solar** – 75 KW si konsumator vetë-konsumues

Aktualisht Intering është duke ndërmarrë aktivitete për zhvillimin e një projekti të ri solar në fshatin Dobrushë të Istogut, me kapacitet 6.2 MW.

Adresa: Rruga Ali Hadri, 15.000 – Kastriot (Obiliq), Kosovë

Tel: +383 (0) 49 767 000

E-mail: intering@interinggroup.com



JAHA SOLAR

Themeluar në Kosovë me një mision të guximshëm të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm në rajon, JAHA Solar mundëson module fotovoltaike dhe zgjidhje energjetike të kualitetit të lartë.

JAHA Solar është prodhuesi i parë dhe më i madh i moduleve fotovoltaike në rajon. Me projekte solare që arrijnë prodhim të lartë dhe ROI atraktive, një portfolio me mbi 15 MWp të projekteve solare me çelësa në dorë e bën JAHA Solar ndër EPC kontraktorët lokal kryesorë rajon.

Me selinë e saj në zemër të Evropës, JAHA Solar ka mobilizuar talente shumë të aftë me moshë mesatare nën 30 vjeç, për të ofruar shërbime eksperte në fushën e shitjes, projektimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së Sistemeve fotovoltaike në nivel ndërkombëtar.

Adresa: Rr. Motrat Qiriazhi, Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë

Mob: +38349696494

Website: www.jahasolar.com

E-mail: sales@jahasolar.com



KAPITAL X

KAPITAL X ofron një staf profesionistësh shumë të trajnuar për dizajnin inxhinieri dhe sistemin e energjisë, një pasuri të njohurive dhe zgjidhjeve inovative për çdo projekt. Shumë prej profesionistëve tanë kanë më shumë se 15 vjet përvojë në menaxhimin e projekteve komplekse. KAPITAL X ka punësuar më shumë se 50 punonjës në zona individuale përgjatë vendit të Kosovës.

Gjetja e një kompanie që zbut rrezikun, merr masa pro-aktive, shpërblen performancën e sigurisë, ekzekuton në mënyrë rutinë pa incidente të regjistruara ose të humbura në kohë dhe minimizon ndikimin mjedisor dhe shoqëror, është thelbësore kur zgjedh një nën-kontraktor.

Qarkullimi vjetor i Kapital X ka arritur deri në K300 Euro.

Ne u ofrojmë klientëve një gamë të plotë të para-ndërtimit të sistemit IT, shërbimeve të ndërtimit dhe konsulentëve përmes udhëheqjes së shëndoshë dhe shtimit të personelit të talentuar të fushës, zyrës dhe mbikëqyrjes.

Pavarësisht nëse projektet janë kapital i madh, kapital i vogël apo hapësira të paketuara, të disiplinuar, ne kemi qasje për secilën me të njëjtin nivel profesionalizmi, integriteti dhe një angazhim për përsosmëri. Kapital X mund të mbështesë projekte të çdo madhësie duke siguruar mjete për "përshtatje të qëllimit" dhe metoda ekzekutimi.

Adresa: Kujtim Spahivogli, nr. 9, Prishtinë, Kosovë

Mob: +383 (0) 049340800

E-mail: kapitalx3@gmail.com



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK)

Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) është kompania më e madhe e Kosovës për minierat dhe prodhimin e energjisë elektrike. Është në pronësi publike dhe operon me kapacitetet e mëposhtme:

- Termocentrali Kosova A (tre njësitë gjeneruese: A-3, A-4, dhe A-5) me kapacitet 400 MW.
- Termocentrali Kosova B (dy njësitë gjeneruese: B-1 dhe B2) me kapacitet 520 MW energji elektrike dhe kapacitet 140 MW për prodhimin e energjisë termike, e cila përdoret për ngrohjen e banesave.
- Divizioni i Prodhimit të Qymyrit - gjeneron deri në 9 milionë tonë qymyr linjit në vit për nevojat e prodhimit të energjisë elektrike.

Në vitin 2022, KEK-u planifikon të prodhojë rreth 6.3 TW (bruto) energji elektrike dhe rreth 9 milionë tonë linjit (thëngjill). Prodhimi i energjisë elektrike nga KEK-u mesatarisht mbulon rreth 94 për qind të konsumit vendor në Kosovë.

Sa i përket kalimit në energji të ripërtërishme, KEK-u është në proces të ndërtimit të dy parqeve me energji solare:

- **Solar4Kosovo - FOTOVOLTAIK I** me mbështetjen e qeverisë gjermane përmes KfW, Bankës Evropiane për Investime dhe KEK-ut.
Ky projekt është planifikuar të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me KfW-në, si financues kryesor, dhe KEK-un, dhe do të financohet nga Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë përmes KfW-së, nga BEI-ja dhe fondet vetanake të KEK-ut. Për këtë park me energji solare me kapacitet 100 MW, do të përdoret një sipërfaqe prej rreth 150 hektarësh.
- **FOTOVOLTAIK II**
Ky projekt është planifikuar të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Korporatën Financiare Ndërkombëtare. Ky projekt pritet të realizohet përmes një partneriteti publiko-privat, duke shfrytëzuar tokat e degraduara të KEK-ut. Partnerët zbatues janë aktualisht në fazën e shënimit të lokacionit të përshtatshëm për këtë projekt.

Adresa: Nëna Terezë nr. 36 - Prishtinë, Kosovë

E-mail: info@kek-energy.com

Website: www.kek-energy.com



MUQA SOLAR COMPANY

Muqa Solar Company është përfaqësues i autorizuar i kompanive të mirënjohura Sonnenkraft, Kioto Solar, Fronius, Effekta, Dimplex, Pumpmakers, CarpetCleaner, sistemet efiçiente të të cilave shfrytëzojnë energjinë diellore që të gjenerojnë ngrohje, ftohje, ujë, dhe energji elektrike, si dhe ofrojnë zgjidhje afatgjata dhe kthim të shpejtë të investimeve kur flitet për panele solare.

Kur përmenden termat “Panele Solare” apo “Përdorimi i energjisë termike”, theksi kryesor duhet të vihet tek përfitimet e shumta që vijnë prej tyre, duke përfshirë arsyet ekonomike, financiare, mjedisore e plot të tjera, të cilat e bëjnë të domosdoshëm aplikimin e energjisë së ripërtërishme për shtëpinë, biznesin apo fabrikën tuaj. Përvoja jonë disa vjeçare në fushën e ndërtimitarisë dhe hidro-sistemeve, si dhe të kuptuarit e nevojave të klientit, janë arsyet bazë që na kanë shtyrë që operacionet tona t’i fokusojmë në Industrinë e Energjisë Solare, në këtë industri të së ardhmes, kursimit dhe rigjenerimit. Të pajisur me sisteme efiçiente, staf të kualifikuar dhe pajisje të teknologjisë së fundit të testuara ndërkombëtarisht, Muqa Solar Company udhëhiqet nga dëshira dhe motivi për t’ju ofruar sistemet solare më efiçiente, më ekonomike, dhe më stabile.

Dielli është miku ynë, bashkëpunëtori dhe industria jonë.

Adresa: Kompleksi EXDX 3, Kati përdhese, Lokali 1, Lagjja Kalabria, Veternik, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel/Fax: +383 (0) 38 712 155 | **Mob:** + 383 (0) 44 266 624

E-mail: info@muqacompani.com

Website: www.muqacompani.com



ProCredit Bank

ProCredit Bank

ProCredit Bank në Kosovë, si pjesë e grupit të bankave ProCredit, është e orientuar drejt kontributit për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë në të cilën operojmë. Ne e vlerësojmë vazhdimisht rëndësinë e veprimeve dhe aktiviteteve tona në lidhje me konceptin tonë për zhvillimin e qëndrueshëm, i cili shkon përtej fokusimit vetëm në rritjen ekonomike. Përkundrazi, ne i gjykojmë veprimet tona në lidhje me përgjegjësinë tonë më të gjerë ndaj vendit ku operojmë.

Zbutjen e riskut mjedisor dhe klimatik e kemi vendosur gjithmonë në qendër të modelit tonë të biznesit. Prej vitit 2011, kemi krijuar një Sistem gjithëpërfshirës për Menaxhim Mjedisor (SMM) me tri shtylla, i cili synon të stimulojë gjurmën tonë ekologjike. SMM-ja adreson ndikimin tonë të brendshëm mjedisor (shtylla 1) dhe ndikimin tonë të jashtëm nëpërmjet vlerësimit të risqeve mjedisore dhe sociale të të gjitha aktiviteteve të biznesit që ne financojmë (shtylla 2) dhe promovimit dhe nxitjes së investimeve dhe deponimeve të gjelbra nga klientët tanë (shtylla 3).

Meqenëse synojmë të nxisim zhvillimin lokal dhe të qëndrueshëm, ne kemi qasja tjetër ndaj financimit të projekteve për energji të ripërtëritshme (ER). Duke mësuar edhe nga përvoja jonë, kemi gjetur një mënyrë për të siguruar financim me efikasitet për projektet në shkallë të vogël bazuar në flukset e tyre të parashikuara të parasë së gatshme, si dhe kemi zhvilluar kapacitete të brendshme dhe jemi angazhuar në partneritete strategjike me ekspertë lokal për financimin e projekteve për ER.

Në vitin 2018, ne vendosëm cakun ambicioz që të arrijmë neutralitetin e karbonit deri në vitin 2023. Progresi ynë reflektohet në rezultatet e iniciativave të ndryshme të brendshme për të reduktuar emetimet tona të CO₂. Si rezultat, i kemi ulur emetimet e gazrave serrë për 34% që nga dhjetori 2018.

Ndër këto përpjekje është investimi në impiantin tonë fotovoltaik MWp (ProEnergy) në Lipjan, fshati Grackë e Vjetër, për të kompensuar emetimet tona të mbetura. Përfitimet sociale, ekonomike dhe mjedisore të projektit përfshijnë:

- OZHQ 7 - Energji e përbalueshme dhe e pastër: Projekti do të gjenerojë energji të pastër dhe nga rrjeti do të zëvendësojë energjinë prej derivateve fosile, duke rritur kështu pjesën e energjisë së ripërtëritshme në miksin energjetik të Kosovës. Kjo do të ketë ndikim pozitiv ndaj klimës për shkak të reduktimit të çlirimit të CO₂. Mesatarja vjetore e MWh të energjisë së ripërtëritshme të prodhuar nga projekti është vlerësuar si 3,909 MWh.
- OZHQ 8 – Punë e denjë dhe rritje ekonomike: Projekti do të mundësojë mundësi punësimi për teknik, asistentë, staf zyre dhe të punësuar të tjerë të ngjashëm, gjatë fazës së ndërtimit dhe O&M. Kështu, projekti do të mbështesë fuqizimin ekonomik lokal nëpërmjet vendeve të reja të punës të krijuara dhe të hyrave të fituara.
- OZHQ 13 - Veprimi për Klimën: Gjenerimi i energjisë së pastër nga projekti i propozuar do të ndihmojë në reduktimin e emetimeve të GS-ve dhe shmangien e ngrohjes globale dhe ndryshimeve klimatike. Projekti pritet të shmangë më shumë se 4,033 ton CO₂ në vit.

Adresa: Rr. Xhorxh Bush, nr.26, Prishtinë

Tel: 038/555-777

E-mail: info@procredit-group.com



RATA SOLAR

“Rata Solar Energy” është kompani me përvojë shumëvjeçare në fushën e energjisë eficiente, e themeluar në vitin 2010 në Prishtinë.

Aktiviteti kryesor është projektimi dhe instalimi i rrjetit elektrik, në veçanti energjisë eficiente diellore dhe energjisë termike. Qëllimi i kompanisë është që klientëve tanë potencial të ju ofrojmë produkte kualitative dhe shërbime cilësore. Bëjmë montimin e energjisë solare në shtëpi private dhe objekte industriale, në tregun e Kosovës dhe jashtë saj.

Punët dhe shërbimet:

- Projektimi dhe konsultimi në montimin e energjisë solare
- Instalimi i energjisë solare fotovoltaike on-grid dhe off-grid
- Instalimi i energjisë termike, sisteme shtëpiake dhe industriale
- Pompa për ujitjen e tokave bujqësore (Plug&Play)
- Instalime elektrike

Adresa: Rr. Përroi i Njelmët, Nr 3, Prishtinë

Mob: +383 (0) 49815500

E-mail: info@ratasolar.com

Website: www.ratasolar.com



SOLAR KOSOVA

Solar Kosova është një biznes i ri në fushën e energjisë së ripërtërishme me fokus energjinë diellore. Solar Kosova është pjesë e kompanisë JENOMA Energy LLC.

Moto e Solar Kosova është: Le të paguajë Dielli për ju !

Solar Kosova ofron shërbime "me çelësa" në dorë për sistemet fotovoltaike - në rrjet, jashtë rrjetit dhe hibride (në rrjet dhe jashtë rrjetit), me ekspertët më të kualifikuar nga kjo fushë dhe me materialet nga prodhuesit liderë të industrisë për secilin komponent të sistemit.

Përparësia e kompanisë sonë është ekspertiza që ne kemi në të gjithë procesin e punës që vjen si rezultat i partneritetit të ndërtuar me kontraktorët më profesionalë që ka tregu rajonal. Përparësi tjetër që ne kemi është fakti se të gjithë komponentët që ne i përdorim i kemi nga kompanitë lidere në këtë industri që janë gjermane, zvicerane, austriake, holandeze.

Adresa: Rr. Bardhyl Qaushi pn, 50000 Gjakovë, Kosovë

Tel: +383 (0) 49 719 019

E-mail: info@solarkosova.com

Website: www.solarkosova.com



SUNVOLTA ENERGY

SUNVOLTA ENERGY

SunVolta Energy Shpk është e angazhuar për të ndihmuar klientët që të reduktojnë faturat e energjisë elektrike me sisteme diellore cilësore dhe çmime të volitshme. Me grupin tonë të instaluesve, ekspertë vendorë e të huaj, sjellim pranë jush brendet e njohura të pajisjeve të dëshmuara në botë. Ne ofrojmë sisteme solare me çelësa në dorë, duke përfshirë evaluimin, projektimin, implementimin, testimin dhe komisionimin.

Shërbimet tona përfshijnë:

- Zhvillimin e sistemeve solare me çelësa në dorë, implementimin, koordinimin, konsultimin, revidimin e projekteve, studimin e fizibilitetit, vlerësimin e propozimeve si palë e tretë, prokurimin e çmimit dhe evaluimin, inspektimin e sistemeve, komisionimin dhe analizën ekonomike.
- Projektimin e detajuar energjetik, duke punuar me arkitektët dhe dizajnerët për integrimin e paneleve solare në ndërtesa, me inxhinierët elektrikë për ta integruar sistemin solar në sistemin energjetik, me inxhinierët e ndërtimit për t'i integruar panelet në strukturën e objektit.
- Specifikimet e pajisjeve solare, furnizimin/shitjen dhe montimin, përgatitjen e dokumenteve për pranim nga autoritetet përkatëse.
- Simulimin e performancës së energjisë së sistemeve, monitorimin, interpretimin e të dhënave dhe analizën e performancës së pajisjeve.

Adresa: Rr. Sheshi Zahir Pajaziti, Hyrja I (përmbi Matisse), 10000 Prishtinë, Kosovë

Mob: +383 (0) 45 667 511 | +383 (0) 44 404 801

E-mail: sunvolta.ks@gmail.com

Website: www.sunvolta-ks.com



UNISOLAR

Unisolar LLC i themeluar në janar të vitit 2021, ne jemi kompani që operojmë në Kosovë dhe në të gjitha shtetet ballkanike. Deri tani kemi projekte në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut. Ne jemi përfaqësues për Kosovë dhe rajon të kompanive lidere botërore si GROWATT NEW ENERGY dhe AE SOLAR GMBH, kompani të cilat ofrojnë gamë të gjërë të produkteve të inverteve dhe paneleve solare.

Unisolar ofron zgjedhje të ndryshme në sistemet fotovoltaike ose thënë ndryshe në sistemet solare, siç janë:

- ON GRID – lidhja me rrjet dhe ngarkesë
- HYBRID – lidhja me rrjet, ngarkesë dhe bateri
- OFF GRID – lidhja vetëm me ngarkesë dhe bateri

Përkushtimi ynë, është shfrytëzimi i resurseve të pashterrshme të energjisë diellore. Gjë kjo e cila na jep edhe më shumë vullnet, duke e ditur që kemi përpara pafundësisht ditë me diell në tokë.

Adresa: Magjisi. Prishtinë-Ferizaj km.4, Veternik, Kosovë

Tel: +383 48 717 200

Email: info@unisolar-ks.com

Website: <https://www.unisolar-ks.com/al>



VV SOLAR

VV SOLAR merret me instalimin e sistemeve solare për ngrohjen e ujit dhe sistemeve solare për prodhimin e energjisë elektrike.

Adresa: Rr. Nënë Tereza, 10000 Fushë Kosovë

Tel: +383 (0) 44 311 954 | +383 (0) 39 535 065

Facebook: VV SOLAR SH.PK



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë - Ministarstvo Ekonomije - Ministry of Economy

me.rks-gov.net